



**VENDIM**

**Nr. 80 Datë 15.06.2012**

**MBI MIRATIMIN E STUDIMIT PËR BORXHIN E KEQ**

Në mbështetje bazuar ne nenin 9 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, vendimit nr. 5690, shpallur ne datën 04.06.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në lidhje me “Anullimin e vendimit nr. 99, date 30.09.2012, “Mbi miratimin e Studimit te Borxhit te Keq“, pikës 5.2 te Deklaratës Rregullatore, VKM nr. 154, date 29.02.2012, “Për miratimin e marrëveshjes tip për fillimin e procedurave për shuarjen me kompensim te detyrimeve te ndërsjellta ndërmjet institucioneve buxhetore dhe jo buxhetore, ndërmarrjeve dhe shoqërive te kontrolluara nga shteti dhe CEZ Shpërndarje sh.a.....” Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 15.06.2012, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

**Konstatoi se:**

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane me vendimin nr. 5690 shpallur me date 4 Qershor 2012, ka vendosur pranimin pjesërisht te padisë se shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a qe kërkonte konstatimin e Pavlefshmërisë Absolute te Vendimit te Bordit te Komisionerëve nr. 99 date 30.09.2011, duke vendosur si te tille anullimin e Vendimit nr. 99 date 30.09.2011, “Për miratimin e Studimit mbi Borxhin e Keq”. Ne kushtet e anullimit te aktit ne fjale nga ana e gjykatës, ERE mbështetur ne Deklaratën Rregullatore pika 5.2 duhet te shprehet lidhur me pranimin ose jo te Studimit për Borxhin e Keq pasi mbas marrjes se vendimit te gjykatës vendimi nr. 99 i Bordit te Komisionerëve nuk sjell me pasoje juridike ne kuptim te Kodit te Procedurave Administrative neni 117.
- Ministria e Financave ne cilesine e Garantuesit sipas Marrëveshjes se Mbështetjes Qeveritare (PRG), me shkresat nr. Prot 4512/3, date 5.04.2012, dhe nr. Prot 4512/7 date 12.06.2012, duke konsideruar kuadrin ligjor respektiv, rekomandimet dhe korrespondencat me Bankën Botërore minimizimin e riskut te ekspozimit te vendit ndaj proceseve gjyqësore vendore dhe ndërkombëtare si dhe për te garantuar furnizimin pa ndërprerje me energji elektrike ka mbështetur propozimin e Bankës Botërore për rikonsiderimin e Borxhit te Keq dhe niveleve përkatëse te tij sipas

supozimeve te studimit, por duke përjashtuar subjektet buxhetore dhe jobuxhetore.

- Çështja e Borxhit të Keq për të cilën është marrë vendimi nr. 99, date 30 Shtator 2011, është ceshtje e garantuar sipas ligjit nr. 10126, date 11.05.2009, “Për ratifikimin e “Marrëveshjes se garancisë ndërmjet Republikës se Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për garantimin e projektit te privatizimit te OSSH sh.a-se”, çështje për të cilin CEZ Shpërndarje ka paraqitur Njoftimin e Pretendimit dhe Njoftimin e ngjarjes pranë Ministrisë se Financave dhe Bankës Botërore.
- Qeveria ne shkresat e nr. Prot 4512/3, date 5.04.2012, dhe nr. Prot 4512/7 date 12.06.2012, te Ministrisë se Financave ne cilesine e Garantorit ka mbështetur propozimin e Bankës Botërore për rikonsiderimin e Borxhit te Keq dhe niveleve përkatëse te tij sipas studimit, duke përjashtuar efektin e mospagesave te subjekteve shtetërore ne nivelin e borxhit te keq, me argumentin se kjo do te minimizonte riskun e ekspozimit te vendit ndaj proceseve gjyqësore vendore dhe ndërkombëtare.
- Banka Botërore ne rolin e palës se përfshire ne marrëveshjen e garancisë ndërmjet Republike se Shqipërisë (përfaqësuar nga Ministria e Financave) dhe Bankës Ndërkombëtare për Garantimin e Projektit te Privatizimit te OSSH sh.a, nisur nga situata financiare e CEZ Shpërndarje, ka kërkuar ne mënyre te vazhdueshme nga palët (Ministria e Financave, Ministria Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikes, ERE, CEZ Shpërndarje dhe KESH) nder te tjera edhe me shkresën nr. 770 Prot., dt. 14.12.2011, ne funksion te përmirësimit dhe për ti dhënë frymëmarrje sektorit, rikonsiderimin prej palëve nder te tjera te nivelit te lejuar te Borxhit te Keq përmes rishikimit te Studimit te Borxhit te Keq.
- Shifrat faktike pjesore te paraqitura nga kompania gjate gjithë kësaj periudhe dhe se fundmi me shkresën nr. Prot 2886/2, date 13.06.2012, kane evidentuar ne përgjithësi se supozimi i bere nga ERE ne lidhje me arkëtimet e viteve 2008, 2009, 2010, aq sa është mundur te implementohen ne modelin e Studimit te Borxhit te Keq, nuk vërtetohet.
- Sipas Studimit te Borxhit te Keq, të Deloitte pjesa Përmbledhja Ekzekutive – Fakte Thelbësore – Skenari i Kompensimit potencial mes CEZ Shpërndarje dhe KESH, Republika e Shqipërisë, nivelet e Borxhit te Keq për vitet 2008, 2009, 2010, janë përkatësit : 14,86%, 16,85 % dhe 19.73%. Këto nivele sipas Deloitte janë rezultat i një skenari kompensimi ndërmjet CEZ Shpërndarje, Kesh dhe Institucioneve te tjera Buxhetore dhe Jobuxhetore, nëse do te ekzistojë një vendim detyrues ligjor dhe/ose një marrëveshje mes palëve.

- Me VKM nr. 154, date 29.02.2012, është aprovuar marrëveshja për shuarjen e detyrimeve të ndërsjella ndërmjet institucioneve buxhetore dhe jobuxhetore ndërmarrjeve dhe shoqërive të kontrolluara nga shteti. Sipas kësaj VKM, Ministria e Financave është autorizuar të përdor gjithë procedurat shtrënguese ligjore për shlyerjen në kohe të detyrimeve ndërmjet palëve.

Për gjithë sa me sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s

### **Vendosi:**

1. Miratimin e Studimit të Borxhit të Keq të përgatitur nga eksperti financiar i pavarur Deloitte. Nivelet e Borxhit të Keq sipas Studimit për vitet 2008 , 2009 , 2010, janë respektivisht 14,86%, 16,85 % dhe 19.73% .
2. Llogaritja e Borxhit të Keq kryhet sipas pikës 5.2 të Deklaratës Rregullatore.
3. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë CEZ Shpërndarje sh.a për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Sokol RAMADANI**